

NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË **KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË** **SAJ**

BASHKIA FIER

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor:

Emri Bashkia Fier
Adresa Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15
Tel/Faks +355 34 410 650
E-mail prokurimetfier@gmail.com
Ueb-faqe www.app.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri:L.Muskaj E-mail: prokurimetfier@gmail.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë “e hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: “Mall”

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-76437-02-17-2026

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje materiali (konglomerat) për rehabilitimin (riparimin) e argjinaturave lumore për mbrojtjen nga lumi Vjosë, të Bashkisë Fier”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Zhavorr, rërë, gurë të grimcuar dhe agregate 14210000-6, Argjilë 14221000-6

8. Fondi limit /(Vlera e pritshme e kontratës/ve): 4 159 974 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqinde shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:
Kontrata është modifikuar bazuar në ligjin 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 127, pika 1, germa “c”, në të cilën citohet se: “kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”, bazuar në urdhërin nr. 6890/1 prot., datë 29.05.2026 dhe në shkresën nr. 6890 prot., datë 29.05.2026, ardhur nga komisioni teknik i ngrtur me urdhërin nr. 2183/15 prot., datë 01.04.2026.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:

- a. Bashkia Fier ka nënshkruar kontratën nr. 2183/14 prot., date 01.04.2026, me kontraktor “Genti 001 SHPK, për objektin “Blerje materiali (konglomerat) për rehabilitimin (riparimin) e argjinaturave lumore për mbrojtjen nga lumi Vjosë, të Bashkisë Fier”.

- b. Afati i realizimit të kontratës ishte parashikuar për një periudhë 60 ditore nga data e lidhjes së kontratës, dhe duhej të përfundonte në datën 01.06.2026.
- Brenda afatit të përcaktuar në paragrafin “b” si me lart, komisioni teknik i ngrtur me urdhërin nr. 2183/15 prot., date 01.04.2026, informoi Titullarin e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Fier, se për arsye të pamundësisë së sigurimit nga ana e investitorit për arsye objektive, të të gjitha mjeteve të nevojshme dhe fuqisë punëtore, sipas kërkesës së bërë nga komisioni teknik (shumë të domosdoshme këto për përfundimin e punimeve sipas parashikimit), si dhe kushtet klimaterike të pa parashikuara, është e pamundur që kjo kontratë të përfundojë brenda afatit të përcaktuar.
- c. Nga ana e komisioni teknik, përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së kontratës, me shkresën 6890 prot., datë 29.05.2026, referuar arsyeve si më sipër, është kërkuar miratimi i shtyrjes së afatit të furnizimit me mallin objekt prokurimi.

PËR SA MË LART, palët bien dakord si më poshtë:

1. Periudha e zbatimit të kontratës shtyhet për një periudhë 60 (gjashtëdhjetë) ditore (nga data 02.06.2026 deri në datën 31.07.2026).
2. Vlefshmëria e këtij Amendamenti shtrihet për një periudhë 60 (gjashtëdhjetë) ditore (nga data 02.06.2026 deri në datën 31.07.2026). në mbështetje të argumenteve të paraqitura nga komisioni teknik dhe miratuar nga Investitori.
3. Për periudhën, për të cilën kërkohet shtyrja e afatit të kontratës, kontraktori merr përsipër të bëjë sigurimin e kontratës, e cila do të jetë e vlefshme për periudhën që kërkohet në këtë amendim kontrate.
4. Të gjithë kushtet e tjera të kontratës së lidhur nr. 2183/14 prot., date 01.04.2026, mbeten të pandryshuara.

Data e nënshkrimit të modifikimit: 29.05.2026

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: është 4 157 400 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind) lekë pa TVSH dhe 4 988 880 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë me TVSH.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): nuk aplikohet

13. Kohëzgjatja e kontratës : jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës (sipas grafikut të furnizimit).

Dhe afati i ri (nëse është rasti): 60 (gjashtëdhjetë) ditore (nga data 02.06.2026 deri në datën 31.07.2026).

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

Genti 001 SHPK, me NUIS L93101401U

Adresë: Fier ZHAREZ SHEQISHTË Fshati Sheqishte, Rruga e qendres, Godina 64, zona kadastrale 3361, nr. Pasurie 102/64.

Tel/Fax 0696900710

E-mail: dervishajilir266@gmail.com

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : 29.05.2026

16. Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Fier.